



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SEKRETARIATI I KËSHILLIT KOMBËTAR TË UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR "VJOSË"

Nr 42 Prot.

Vlorë, më 17 . 10 . 2018

VENDIM

Nr. 9 _ Data 10.10.2018 _

Për miratimin në parim të kërkesës, për shfrytëzim të përroit të Hormovës, degë e lumit Drino, degë e lumit Vjosë, për ndërtimin e hidrocentralit "Hormovë " për prodhim të energjisë elektrike, Bashkia Tepelenë , qarku Gjirokastrë, subjektit "HYDRO POWER PANARIT" sh.p.k., me administrator Z. Banush Sulaj .

Në bazë të ligjit Nr.111/2012 datë 15.11.2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", ligjit nr 6/2018 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 111/2012 " Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore" të V.K.M 416 datë 13.05.2015 "Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore", , Vendimit Nr. 876, datë 14.12.2016 "Për miratimin e tarifave të shpenzimeve administrative" si dhe Vendimit Nr. 662 datë 21.09.2016 "Miratimin e tarifave të përdorimit të ujit dhe të shkarkimeve të lëngëta ", Vendimit Nr.5 datë 16.02.2016, Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor", Vendimit Nr.6 datë 16.02.2016, Për miratimin e rregullores "Për funksionimin e Agjencisë së Basenit Ujor"; V.K.M Nr.822, datë 07.10.2015, "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni",

VENDOSI

Miratimin në parim të kërkesës, për shfrytëzim të përroit të Hormovës, degë e lumit Drino, degë e lumit Vjosë, për ndërtimin e hidrocentralit "Hormovë " për prodhim të energjisë elektrike, Bashkia Tepelenë , qarku Gjirokastrë, subjektit "HYDRO POWER PANARIT" sh.p.k., me administrator Z. Banush Sulaj me këto të dhëna:

Koordinatat KRGJSH: X 508220; Y 4455936; Z 362

Prurja mesatare : 0.103 m³/sek

Prurja e llogaritur: 0.35 m³/sek

Adresa: Godina e Drejtorisë së Bujqësisë, Kati i parë e-mail: aubvjosavlore@gmail.com Faqe 1 of 2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SEKRETARIATI I KËSHILLIT KOMBËTAR TË UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR "VJOSË"

Prurja e ekologjike: 0.06 m³/sek

Godina e centralit X 507857 Y 4455454 Z 239

Fuqia e instaluar e hidrocentralit llogaritetet të jetë 340kW

Për përdorimin e këtij burimi uhor duhen të plotësohen me përpikmëri kushtet e lejes.

Ngarkohet ABU për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

PËRGJEGJËS I A.B.U "VJOSË"

Ilir PROFKA



KRYETAR I K.B.U "VJOSË"

Flamur MAMAJ

